

REMZI PËRNASKA

RRETH DISA ÇËSHTJEVE TË KUNDRINËS NË GJUHËN SHQIPE

Kundrina, e parë qoftë në kuadrin e gjymtyrëve të dyta, qoftë në vetvete, paraqet një sërë çështjesh problemore. Në këtë kumtesë do të trajtojmë, përsa na lejon vendi, vetëm disa prej tyre, që lidhen sidomos me kufijtë e kundrinës me rrethorët.

I. Në gjuhën shqipe, kundrina është gjymtyrë e dytë e fjalisë. Ndryshe nga tradita gramatikore e disa gjuhëve, ku kundrina është gjymtyrë kryesore e fjalisë, sepse ka treguesit e vet gramatikorë në përbërjen e kallëzuesit, në traditën tonë gramatikore, veç K.Cipos¹, me të drejtë, kundrina është trajtuar si gjymtyrë e dytë e fjalisë. Dhe me të vërtetë, gjymtyrët kryesore të fjalisë dallohen nga gjymtyrët e dyta jo aq nga pesha kuptimore, se sa nga roli i ndryshëm gramatikor.

Kundrina, duke qenë se në brendi shënon sende e fenomene, afrohet, p.sh., me kryefjalën², por ndryshon prej saj, sepse në planin e shprehjes, ndryshe nga kryefjala që del si gjymtyrë e pavarur, nga fillojnë lidhjet sintaksore të fjalëve në fjali, është gjymtyrë e varur që nuk merr pjesë në ndërtimin e «togut predikativ» dhe bashkohet me lidhje nënrenditëse drejtimi me gjymtyrën nga e cila varet.

Duhet pasur parasysh, nga ana tjetër, se kryefjala dhe kundrina e drejtë, nëpërmjet kallëzuesit, takohen me njëra-tjetrën, hyjnë në marrëdhënje të caktuara, të cilat nuk shprehen gjuhësisht, por nga ana semantike janë mjaft të qenësishme. Këtej del se kundrina e drejtë nuk plotëson vetëm një gjymtyrë kryesore të fjalisë, thuhet zakonisht kallëzuesin, por ndihmon në zgjerimin e përmbajtjes së krejt fjalisë; kjo bëhet më e qartë po të kihet parasysh se kundrina e drejtë mund të kthehet në kryefjalë të ndërtimit pësor, prandaj nuk duhet quajtur i plotë qëndrimi që mbahet në gramatikat tona e që kundrinën e drejtë e lidh vetëm me kallëzuesin.

II. Përkufizimet e deritanishme të kundrinës janë të papranueshme.

1 — Si pasojë e shikimit logjicist të fjalisë dhe gjymtyrëve të saj, edhe kundrina është bazuar me frymorin a gjënë³, megjithëse është gjymtyrë fjalie e jo frymori apo sendi vetë.

1) K. Cipo, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë 1949, kundrinat i trajton si gjymtyrë të dyta, kurse në *Sintaksën*, botuar më 1952, kundrinën e zhdrejtë e trajton si gjymtyrë të dytë, ndërsa kundrinën e drejtë si gjymtyrë kryesore. Në f. 64 ai shkruan: «Më sipër pamë se elementet kryesore të një fjalie ishin: kryefjala (subjekti), predikati dhe kundrina e drejtë (objekti)».

2) S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, pjesa e parë, 1959, f. 116. «Po të shqyrtojmë kundrinën si brendi, do të gjejmë analogji të plotë pothuaj me kryefjalën».

3) K. Cipo, *vep. cit.*, f. 63: «Objekti a kundrina është frymori a gjëja mbi të cilën bie veprimi i subjektit».

2 — Nuk është gjithmonë e vërtetë që kundrina tregon sendin mbi të cilin *bie* (nënvizimi ynë — R.P.) veprimi i foljes a kallëzuesit foljor, i subjektit, i kryefjalës ose i gjymtyrës prej së cilës ajo varet⁴. Ky përkufizim, në radhë të parë, është mjaft i ngushtë. Kalimi i veprimit është karakteristik vetëm për një kategori të caktuar kundrinash dhe nuk është tipari themelor i kundrinës, se, po të ishte ashtu, nga njëra anë, do të mirrej si kundrinë edhe emërorja (kryefjala) e ndërtimit përsor, meqë tek ajo bie veprimi i subjektit (p.sh. *hekurudha* Elbasan-Prrenjas po ndërtohet nga rinia), kurse nga ana tjetër, nuk do të mirreshin si kundrinë kallëzoret pa parafjalë dhe dhanoret e ndërtimeve të tilla: ka ende *njerëz* që mirren me thashetheme; *më* dhemb koka; t'u rrit djali etj, me që nuk shënojnë objektin mbi të cilin bie veprimi. Del e nevojshme, pra, të zgjerohet domosdo përmbajtja e përkufizimit të kundrinës në gjuhën shqipe.

3 — Në të gjitha gramatikat tona, nga mënyra e kalimit të veprimit mbi objektin, kundrinat janë dalluar në të drejta dhe të zhdrejta⁵, kurse nga mënyra e shprehjes së këtyre kundrinave, është barazuar kundrina e drejtë me forma të rasës kallëzore pa parafjalë dhe kundrina e zhdrejtë me forma të rasës dhanore të emrave, përemrave. pjesëve të substantivuara të ligjëratës etj.⁶. S.Prifti pranon se ka përjashtime të pakta⁷.

Këto barazime janë të papranueshme, sepse, në fund të fundit, njëzojnë përmbajtjen me formën.

Megjithëse veçoritë sintaksore të kundrinave, ashtu si edhe të gjymtyrëve të tjera të dyta, mbështeten dhe zhvillohen në bazë të kategorive morfologjike, megjithëse midis gjymtyrëve të fjalisë dhe pjesëve emëruese të ligjëratës ka lidhje, prapëseprapë midis tyre s'mund të vihet shenja e barazisë. Problemi qëndror në përcaktimin e kundrinës nuk është forma rasore e emrit, përemrit a pjesës së substantivuar të ligjëratës.

Objekti mbi të cilin bie veprimi drejtpërdrejt mund të shprehet jo vetëm me format e rasës kallëzore pa parafjalë (në gjuhën e folur, rrallë dhe në ndërtime të caktuara edhe me ato të rrjedhore: s'kemi ngrënë *këso mollësh*)⁸, por edhe me ato të dhanores ose të ndonjë rase tjetër të paraprirë nga parafjalët. Edhe objekti mbi të cilin bie zhdrejtazi veprimi mund të shprehet me emër, përemër, pjesë e substantivuar e ligjëratës jo vetëm në rasën dhanore, por edhe me forma rasash të tjera të parapirira nga parafjalë. Kjo del më mirë në pah, po të kihet parasysh që disa folje marrin barabar emra, përemra, pjesë të substantivuara të ligjëratës në format e rasës kallëzore pa parafja-

4) A. Xhuvani, *Njohurit e para të sintaksës shqipe*, 1935, f. 13; S. Prifti, *vep. cit.*, f. 115; M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksë për shkollat pedagogjike*, 1966, f. 30; N. Havjari, *Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa për klasën VII*, 1967, f. 50.

5, 6) I.D. Sheperi, *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë 1927, f. 153; A. Xhuvani, *vep. cit.*, f. 13; M. Domi, *vep. cit.*, f. 32; S. Prifti, *vep. cit.*: f. 122.

7) S. Prifti, *vep. cit.*, f. 122: «... kundrina e drejtë vihet gjithmonë në rasën kallëzore, kurse kundrina e zhdrejtë vihet gjithmonë në rasë dhanore, me përjashtime të pakta».

8) M. Domi, *vep. cit.*, f. 30.

lë, në format e dhanores⁹, ose edhe në forma të tjera rasore të para-prira nga parafjalët, pa ndonjë ndryshim të qenësishëm të kuptimit:

a- pa ndryshuar formë: *e ndihmoj - i ndihmoj, e kundërshtoj - i kundërshtoj, e besoj - i besoj* (në kuptimin: *i zë besë e jo në kuptimin i besoj atij diçka*) - *besoj në ndërgjegjen e shokut, i mbaj mëri vëllajt - mbaj mëri me vellanë, i largohem a i shmangem atij* — largohem a shmangem nga ai etj.

b — duke ndryshuar formë: *e kërcënoj atë* — *i kërcënohem atij.*

c — duke ndërruar foljen me një shprehje me po atë vlerë leksikore: *e përballoj - i bëj ballë, e besoj - i zë besë, e ndihmoj - i jap ndihmë etj.*

Shembujt e mësipërm tregojnë se kriteri ekzistues i ndarjes së kundrinave në të drejta e në të zhdrejta sipas mënyrës së kalimit të veprimt mbi objektin është i papërshtatshëm jo vetëm se nuk mbulon të gjitha kundrinat, por edhe sepse kufiri midis njërës dhe tjetrës kundrinë është i ndërkalueshëm; dhe në praktikë ne e braktisim atë duke përcaktuar kundrinën e drejtë e të zhdrejtë jo më nga mënyra e kalimit të veprimt, po nga forma rasore e emrit, përemrit e pjesës së substantivuar të ligjeratës që shpreh këtë objekt.

Shembujt e mësipërm tregojnë gjithashtu se përkufizimi i kundrinës duhet të zgjerohet edhe në planin e shprehjes: të pranohet edhe kundrina me parafjalë¹⁰.

III. 1 — Duke e zgjeruar kundrinën si në planin e përmbajtjes, ashtu edhe në planin e shprehjes, e përkufizojmë kështu:

Kundrina është gjymtyra e dytë e fjalisë që shpreh marrëdhënje objektore dhe që lidhet me drejtimin me gjymtyrën prej së cilës ajo varet.

Marrëdhënje objektore janë marrëdhënjet midis sendit dhe procesit a tiparit ose edhe midis dy sendeve¹¹, kurse drejtimin quhet ai lloj i lidhjes sintaksore nënrenditëse, kur përdorimi i formave të rasave, me ose pa parafjalë, të fjalëve të varura, është i kushtëzuar nga kuptimi gramatikor ose leksiko-gramatikor i fjalës varëse¹².

Po të kemi parasysh se marrëdhënjet objektore shprehen midis sendit dhe procesit a tiparit, apo midis dy sendeve, se gjymtyra bosht që shpreh proces, mund të jetë jo vetëm folje, por edhe mbiemër foljor, p.sh. *kush i ka parë ato vise të bukura...*, *ato male të veshura me pisha, me bredha e me boriga të larta...* ai nuk i harron kurrë. (V. Kona Me valët e jetës I, f.167) a emër foljor p.sh.: *Tollumbi i zaptuar nga demonstronjësit, pushoi së hedhuri ujë.* (S. Spasse, Ata nuk ishin

9) A. Dhrimo, *Një vështrim mbi foljet me më se një reksion në shqipen e sotme letrare*, SF, 2, 1965, f. 147: «Duhet shënuar se në shprehjet: *e besoj shokun — i besoj shokut; e kundërshtoj — i kundërshtoj; e ndihmoj shtëpinë — i ndihmoj shtëpisë; e përballoj — i përballoj etj.*, nuk kemi dy kuptime qartësisht të ndryshëm, por dy theksime lehtësisht të dallueshëm, stilistikisht të pabarabartë». S. Prifti, *vep. cit.*, f. 118: «Ka folje që kundrinën e marrin herë në rasën kallëzore, herë në rasën dhanore, pa ndryshim të dukshëm kuptimi, p.sh. «I ndihmoj shtëpisë (dhanore)», dhe «e ndihmoj shtëpinë (kallëzore)»

10) J. Rrota është i pari në traditën tonë gramatikore që pranon kundrinë me parafjalë. Shih J. Rrota, *vep. cit.*, f. 34: «::: një kundrinë emën, prim nga një parafjalë... thirret kundrinë parafjalore (ose objekt prepozicionar)».

11) *Sovremennyj russkij jazyk II*, Pod red. prof. E.M. Gallkinoj-Fjedoruk 1964, f. 360; Smirnickij, A.I., *Sintaksis anglijskogo jazyka*, 1956, f. 185.

12) ANSSSR, *Grammatika russkogo jazyka*, Tom II, çastj pjervaja. 1960, f. 22, *Sovremennyj russkij jazyk*, II, Pod red. prof. E.M. Gallkinoj-Fjedoruk, 1964, f. 270; Gvozdejev A.N., *Sovremennyj russkij literaturnyj jazyk*, II, 1961, f. 32.

vetëm, f.178)¹³, kurse gjymtyra që shpreh tipar mund të jetë jo vetëm mbiemër p.sh.: Që nga viti 1933 punonte pranë zotit Bakalli..., një burrë i leshtë nga sjellja, po shumë i frikshëm në punët politike. (Sh. Musaraj, Para agimit I, f.5), por shumë rrallë ndajfolje p.sh.. X shkruan qartë për të vegjëlit, shkruan padallueshëm për të tjerët: Nga ana tjetër po të kemi parasysh se gjymtyra e varur e togfjalëshit me marrëdhënje objektore mund të shprehet jo vetëm me forma të rasës kallëzore pa parafjalë dhe dhanore, por edhe me forma të tjera rasore të paraprirra nga parafjalët, kuptohet vetvetiu që shtrirja që ne i japim kundrinës është më e madhe nga shtrirja e kundrinës në të gjitha tekstet tona¹⁴, duke përfshirë edhe atë të J.Rrotës.

2 — Nga sa u shtjellua më sipër del qartë se ndarja e kundrinave në të drejta dhe të zhdrejta nuk mund të bëhet gjithmonë sipas karakterit të kalimit të veprimit mbi objektin. Veç rasteve të mësipërme, po shtojmë se edhe përdorimi pleonastik i trajtave të shkurtëra të përemrave vetorë të vetës së tretë njëjës në rasën kallëzore (p.sh. A s'ja marrim një kënge partizane?) tregon se dallimi kuptimor i kundrinës së drejtë nga e zhdrejta në disa raste është zero, pra dëshmon për papërshtatësinë e këtij kriteri.

Dallimi i kundrinës së drejtë nga kundrina e zhdrejtë nuk është aq shumë kuptimor se sa sintaksor dhe kushtëzohet nga vetë veçoritë ndërtimore të shqipes. Ne mendojmë se dallimi i tyre bëhet mirë për shqipen në planin sintaksor, sepse kundrina e drejtë mund të kthehet në kryefjalë të fjalisë me ndërtim pësor, kurse kundrina e zhdrejtë nuk e ka një mundësi të tillë në gjuhën shqipe. Po shtojmë se kundrina e zhdrejtë me parafjalë që shpreh vepruesin e ndërtimit pësor mund të rikthehet në kryefjalë të ndërtimit vepror. Si përfundim, kundrina e drejtë shprehet me format e rasës kallëzore pa parafjalë, kurse e zhdrejta me format e dhanores ose edhe të emërores, gjindores, kallëzores, rrjedhores të emrave, përemrave etj. të paraprirra nga parafjalët ose shprehjet parafjalore.

Megjithatë, dallimi i kundrinës së drejtë nga e zhdrejta nuk është aq i madh sa në ndonjë gjuhë tjetër, si p.sh. në rusisht, por është më i madh se në anglisht, ku dallimi është pothuajse zero, sepse edhe kundrinat e zhdrejta mund të kthehen në kryefjalë. Shqipja, në këtë pikë, zë vend midis anglishtes e rusishtes, duke qëndruar më pranë rusishtes.

3 — Kundrina e zhdrejtë me parafjalë ka shtrirje më të gjërë se sa rastet kur është e këmblyeshme me kundrinë të drejtë e të zhdrejtë të dhanores, me që ajo klasifikohet e trajtohet sipas vetë thelbit të

13) Kundrinë të drejtë mund të marrë emri foljor i gjinisë asnjësore, kryesisht në rasën emërore, p.sh.: të ngrënë bukë, të pirët ujë, etj. Ky tip i togfjalëshave objektorë haset rrallë në gjuhën e folur, edhe më rrallë në gjuhën e shkruar. Përdorim më të dendur kanë këto togfjalësha, kur emri foljor i gjinisë asnjësore është në rasën rrjedhore, p.sh.: mbaroi së ngrëni bukë. (Për këtë shih Sh. Demiraj, Rreth disa problemeve të paskajores në gjuhën shqipe, në SF, 1, 1969, f. 114). Kundrinë të zhdrejtë mund të marrë emri foljor i gjinisë femërore në ndërtim të caktuar: Emër foljor i gjinisë femërore + Emër në rasën gjindore (ky emër shënon objektin e veprimit) + Emër në dhanore. P.sh.: Dhënja e tokës fshatarëve ngjalli tek ata dëshirën dhe interesin për një shfrytëzim më të mirë të tokës, për një zhvillim më të shpejtë të forcave prodhuese në bujqësi. (Historia e PPSH, f. 225).

14) S. Floqi, në kursin e leksioneve të lexuara në degën e gjuhëve të huaja të Fakultetit të historisë dhe të filologjisë, tek kundrinat ka shtënë edhe *plotësit e vepruesit, të mjetit, të argumentit* etj.: duke i dhënë kundrinës shtrirje të gjërë. M. Domi në leksione, pranon kundrinën me parafjalë vetëm në raste shumë të kufizuara.

përkufizimit të kundrinës, si gjymtyrë e varur që shpreh marrëdhënje objektore.

Në shtrirjen e kundrinës së zhdrejtë me parafjalë në shtiem të gjitha ato ndërtime që janë kategorizuar si plotës i vepruesit^{15/1}, i shoqërimit^{15/2}, i mjetit^{15/3}, i argumentit^{15/4}, i dobisë e i dëmit^{15/5}, i kufizimit^{15/6}, i zëvendësimit e i shkëmbimit^{15/7}, i plotnisë dhe i mungesës^{15/8} etj.; disa lloje të caktuara semantiko-strukturore të plotësit të prejardhjes dhe të largimit^{15/9}, si edhe shumë ndërtime të tjera, të cilat ose janë vënë re^{15/10} dhe janë shtrënë herë tek njëri plotës rrethor e herë tek tjetri, ose nuk janë vënë re fare dhe nuk janë trajtuar në tekstet e sintaksës.

Në planin e shprehjes, kundrina me parafjalë ndërtohet pothuajse me të gjitha parafjalët e rasës emërore, kallëzore e rrjedhore, si edhe me shprehje parafjalore. Shumica e parafjalëve i paraviihet emrit, rëremrit, pjesës së substantivuar të ligjëratës për të ndërtuar si kundrinën, ashtu edhe përcaktorin e rrethanorin, por ka edhe parafjalë të atilla që shërbejnë për të ndërtuar vetëm kundrinën si, p.sh., parafjala *kundër*, shprehjet parafjalore *me anën e*, *në vend të*, *në kundërshtim me* etj. ose për të ndërtuar kryesisht kundrina si parafjala *ndaj*, *nëpërmjet* etj.; nga ana tjetër, ka edhe parafjalë e shprehje parafjalore që është vështirë t'i gjesh me kundrina si *kundruall*, *larg*, *afër*, *përmas*, *sipër gjatë*; *rrotull* etj. kurse disa të tjera përdoren rrallë e tek për të ndërtuar kundrina si *para*, *kundrejt*, *rreth* etj.

Parafjala *për*, kur i paraprin emrit, përemrit nëses së substantivuar të ligjëratës në rasën rrjedhore, shërben për të ndërtuar kryesisht kundrinën, ndërsa, kur i paraprin emrit, përemrit, pjesës së substantivuar të ligjëratës në rasën kallëzore, shërben për të ndërtuar si kundrinën, ashtu edhe përcaktorin e rrethanorin.

Në pjesën më të madhe të rasteve parafjala mbetet po ajo, kur ndryshon natyra leksiko-gramatikore e gjymtyrës bosht të togfjalëshit që shpreh marrëdhënje objektore, p.sh.: punoj, punim, i punuar *me* traktor; ndryshoj, i ndryshëm, ndryshe *nga* kundërshtari.

Ata ishin të rinj nga mosha e ndryshonin shumë nga të parët (nga njerëzit e parë — R.P.) edhe nga veshja, edhe nga zakonet, edhe nga bisedat e tyre (Sh.Musaraj, Para agimit, I, f. 25) dhe: Rrethanat e jetës e kishin qitur në një rrugë tjetër, të ndryshme nga ajo e bashkëatdhetarëve të tij që... ishin rritur pas bravareve të tyre, ose më keq akoma, si yzmetçinj të përbuzur nëpër dyer bote (po aty, f.5).

Ka edhe pak raste që, me ndryshimin e natyrës leksiko-gramatikore të gjymtyrës bosht të togfjalëshit që shpreh marrëdhënje objektore, këmbëhet edhe parafjala, p.sh.: dëmton shëndetin — i dëmshëm për shëndetin.

Këmbimet më të mëdha të parafjalëve në togfjalëshat me marrëdhënje objektore vihen re në ato raste, kur, në vend të ndërtimit të parë

15) A. Xhuvani, *Sintaksa shqip*, Tiranë 1938, për 15/1 f. 24, për 15/2 f. 14, për 15/3, f. 13, për 15/5 f. 17, për 15/6 f. 19, për 15/8 f. 21, për 15/9 f. 23, 28; K. Cipo, *Sintaksa*, 1952, për 15/1 f. 76, për 15/2 f. 84, për 15/3 f. 74, për 15/4 f.83, për 15/5 fq. 77, për 15/6 f. 84, për 15/7 f. 78-79; për 15/8 f. 85, për 15/10 f. 76; M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksë për shkollat pedagogjike*, 1966, për 15/1 f. 83, për 15/2 f. 75, për 15/3 f. 70, për 15/5 f. 77, për 15/6 f. 56, për 15/9 f. 63, për 15/10 shih: M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe, Pjesa e dytë, sintaksa*, 1957, f. 110; S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe, pjesa e parë*, 1959, për 15/1 f. 162, për 15/2 f. 173, për 15/3 f. 171, për 15/6 f. 179, për 16/7 f. 154, për 15/9 f. 153, për 15/10 f. 155; N. Havjari, *Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa për kl. VII*, 1967, për 15/1 f. 115, për 15/2 f. 107, për 15/3 f. 107.

me ose pa parafjalë, sot përdoren ndërtime të reja, qofshin këto të natyrës së shqipes, që për arësye të ndryshme po bëhen prodhimitare, qofshin ndikime nga gjuhët e huaja. Këto ndërtime mund të sajohen nga dy ose më shumë parafjalë, prandaj ka edhe shumë luhatje. Në disa raste duket qartë prirja për të mënjeluar njëren parafjalë e për ta zëvendësuar me një tjetër. Në togfjalëshat kundrinorë, parafjala *te* zëvendësohet nga parafjala *në*, kurse parafjala *mbi*, kur kundrina shënon objektin që shërben si argument, gjithnjë e më shumë zëvendësohet nga parafjala *për*, e, në sfera të caktuara, si në gjuhësi, nga parafjala *rreth*. Edhe parafjalët *nga* dhe *prej*, në togfjalësha kundrinorë, këmbehen lehtë midis tyre, me përjashtim të ndasorëve. Për disa raste të tjera është shumë vështirë të përcaktosh prirjen pa ndihmën e statistikës gjuhësore.

IV. Megjithëse kemi bërë hetim strukturoro-semantik të kundrinave me parafjalë, ato nuk janë bërë objekt i kësaj kumtese, sepse si nga plani i përmbajtjes, ashtu edhe nga plani i shprehjes, duket qartë se janë kundrina. Po trajtojmë vetëm dy raste të veçanta, ndër më problemoret, të kundrinës me parafjalë.

1. Më sipër u tha se veprimi mund të bjerë edhe mbi kryefjalën në ndërtimin pësor. Kryefjala e ndërtimit pësor nuk tregon objektin veprues, por objektin e veprimit, dhe në fjali është fjala nga fillojnë lidhjet sintaksore, prandaj duket sikur i ngjet një hibridi: kundrinë në përmbajtje, kryefjalë në shprehje. P.sh. Socializmi ndërtohet nga *duart* tërë kallo (Zëri i Popullit, 6.V.69, f. 2).

Në ndërtimin vepror kryefjala shënon objektin veprues në planin e përmbajtjes, kurse në planin e shprehjes është fjala nga fillojnë lidhjet gramatikore .P.sh. Socializmin e ndërtojnë *duart* tërë kallo.

Si del nga shembujt të dy gjymtyrët *socializmi* dhe *duart*, janë fjalë gramatikusht të pavarura të fjalisë, prandaj, për arësye gjuhësore, kategorizohen si kryefjalë.

Gjithashtu, nga krahasimi i ndërtimit vepror me atë pësor del se në brendi kryefjala dhe kundrina mund të jenë të barabarta: *socializmi-socializmin*. I njëjti fenomen i realitetit objektiv është pasqyruar në ndërgjegjen tonë në mënyra të ndryshme. Ky pohim vlen edhe për gjymtyrët nga *duart* tërë kallo — *duart* tërë kallo.

Si duhet kategorizuar atëhere fakti gjuhësor nga *duart*, si plotës i vepruesit apo si kundrinë me parafjalë?

Gjatë këmbimit të ndërtimit vepror të fjalisë në atë pësor kundrina *socializmin* kthehet në kryefjalë *socializmi*, prandaj edhe kryefjala *duart* duhet të kthehet në kundrinë nga *duart*.

Në gjuhën shqipe në ndërtimin pësor vepruesi zakonisht nuk shprehet dhe ky është treguesi tjetër gramatikor që kryesorja nuk është shprehja e vepruesit, por shprehja e objektit të veprimit si kryefjalë.

Nga sa u tha më sipër del se, për vetë ndërtimin e fjalisë, më të qenësishme janë bashkëmarrëdhënjet e kryefjalës me kundrinën se sa me gjymtyrë të tjera, sepse ndryshimi i njëres sjell ndryshimin e tjetrës. Duke qenë se gjymtyrët e tjera nuk sjellin ndryshime në ndërtimin e fjalisë, nuk ngatërrohen në marrëdhënje midis kryefjalës e kallëzuesit, si bën kundrina e drejtë, është i padrejtë kategorizimi i ndërtimeve të tipit nga *duart* si plotës vepruesi, por, përkundrazi, duke qenë i barabarti i kryefjalës së ndërtimit vepror, por gjuhësisht gjymtyrë e varur e ndërtimit pësor, ato duhen kategorizuar si kundrinë me

parafjalë. Të mos e kategorizosh si kundrinë me parafjalë vetëm e vetëm sepse nuk tregon objektin e veprimit, do të thotë ta mbivlerësosh përmbajtjen e ta shkëpusësh atë nga forma. Në gjuhën shqipe ka edhe raste të tjera, ku kundrina nuk shpreh objektin e veprimit.

Kundrina të shumtën e herës shpreh objektin e veprimit, po ky nuk është i vetmi tipar i domosdoshëm për t'i klasifikuar gjymtyrët si kundrina, ashtu si kryefjala rëndom shpreh objektin veprues, por ky, gjithashtu, nuk është i vetmi tipar i domosdoshëm për t'i klasifikuar gjymtyrët si kryefjalë, sepse ndryshe në shembullin e mësipërm *socializmi* nuk do të ishte kryefjalë. Përcaktues këtu duhet të jetë roli gramatikor dhe sipas këtij roli gramatikor, e pamë, vepruesi i ndërtimit pësor është kundrinë, një lloj i veçantë i kundrinës me parafjalë.

Kundrina me parafjalë që shënon vepruesin e ndërtimit pësor, në gjuhën e sotme letrare shprehet me emra, pjesë të tjera të substantivuara të ligjëratës në rasën emërore zakonisht të shquar, të paraprirë nga parafjala *nga*, ose nga parafjala *prej*, kur kjo kundrinë shprehet me përemra¹⁶. Në ligjërimin popullor, gegërishtja parapëlqen gjithandej parafjalën *prej*, kurse toskërishtja parafjalën *nga*¹⁷. Në sfera të veçanta, si në gjuhën e shkresave zyrtare, në atë politike, etj. kjo kundrinë mund të shprehet, si ndikim nga gjuhët e huaja, edhe me shprehjet parafjalore *nga ana e*, *prej anës së* para emrave apo përemrave etj.¹⁸

Midis gjuhës së folur dhe asaj të shkruar ka ndryshim përsa i përket shprehjes së kësaj kundrine: ndërsa në gjuhën e folur pas foljeve të diatezës pësore kjo kundrinë zakonisht nuk shprehet¹⁹ dhe në vend të ndërtimit pësor përdoret ndërtimi vepror, në gjuhën e shkruar, krahas ndërtimeve mbizotëruese veprore, përdoren edhe ndërtimet pësore me veprues të shprehur. Ndërtimin pësor, si edhe kundrinën që shpreh vepruesin e saj, me zhvillimin e gjuhës, me kristalizimin e normave letrare, shqipja po e përdor më dendur, sepse ka vlera kuptimore e stilistikore pak a shumë të ndryshme nga ato të ndërtimit vepror.

Në qoftë se pas foljeve të diatezës pësore shprehja e kësaj kundrine nuk është e domosdoshme, mbas gjymtyrëve bosht të shprehura me mbiemra preifoljorë prania e kundrinës që shënon vepruesin, është e domosdoshme²⁰; p.sh.: Kur ju afrua fortesës, dërgoi përpara të nipin Hamzë Kastriotin, si sekretar të tij, që ta lajmëronte kumandarin e kështjellës që arrinte për së shpejti i urdhëruar *prej Sulltan Muradit II* të merrte kumandën e saj. (F. Noli, *Histori e Skënderbeut*, Boston 1920, f. 101).

2. Në gjuhën shqipe ka edhe raste të tjera, ku, në brendi, kryefjala është e njëvlershme me një gjymtyrë tjetër gramatikiisht të varur.

16) M. Çeliku, *Çeshtje të normës morfologjike në letërsinë artistike pas çlirimit*, SF, 3, 1969, f. 114.

17) Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, II, 1967, f. 274. Po shënojmë këtu se disa autorë jugorë si S. Frashëri, F. Noli, N. Bulka etj. parapëlqejnë parafjalën *prej* për të shprehur vepruesin e ndërtimit pësor.

18) K. Cipo, *vep. cit.*, f. 76; M. Domi, *vep. cit.*, f. 83;

19) K. Cipo, *vep. cit.*: «Plotësi i agjentit është një plotës që dëgjohet rrallë në shqipen e folur» dhe «Megjithatë, fare pa shembëlla të plotësit të agjentit nuk është letërsia jonë popullore», M. Domi, *vep. cit.*, f. 83.

20) M. Domi, *vep. cit.*, f. 83: «Plotësin vepronjës... e gjejmë më shpesh me mbiemrat foljorë»

Këto raste kanë të bëjnë me ndërtime të caktuara të «plotësit të shoqërimit». Të tilla janë ndërtimet: kryefjalë në njëjës + «plotës shoqërimi» + kallëzues në njëjës apo shumë, kryefjalë në shumë + «plotës shoqërimi» + kallëzues në shumë. Homogjenia brendiore dallohet edhe gjuhësisht jo vetëm sepse emri, përemri apo pjesët e substantivuara të ligjëratës të paraprirra nga parafjala *me*, rëndom janë në trajtë të shquar, si edhe vetë kryefjala, dhe parafjala *me* është e këmbyeshme me lidhëzat bashkërenditëse shtuese *e*, *dhe*, *edhe*, por edhe sepse, kur ndërtimi vepron i tyre kthehet në ndërtim pësor, «plotësi i shoqërimit» kthehet në kryefjalë. Kategorizimi i tyre si plotës shoqërimi është i papranueshëm jo vetëm për arësye të homogjenisë brendiore, por edhe për arësye gramatikore, kështu p.sh. në ndërtimin: *kryefjalë në njëjës* + «plotës shoqërimi» + kallëzues në shumë kallëzuesi nuk është «përshtatur» vetëm në kryefjalën, por edhe me «plotësin e shoqërimit», prandaj togu: *kryefjalë* + «plotës shoqërimi» duhet marrë si kryefjalë e vetme, p.sh.: *Hamiti me Xhemalin* ranë në erë të tradhëtisë, kur posta e Belshit bastisi nja dy persona. (Dh. Shuteriqi, Çlirimtarët II, f. 199). Kur kallëzuesin e vënë në shumë, shqipfolësit në këto raste në vend të parafjalës *me* parapëlqejnë lidhëzat *e*, *dhe*, *edhe*.

Gjithashtu, është i papranueshëm kategorizimi i tyre si kryefjalë e vetme në ndërtimin shumë të përdorur: *kryefjalë në njëjës* + «plotës shoqërimi» + kallëzues në njëjës, sepse «përshtatja» e kallëzuesit vetëm me kryefjalën tregon se «plotësi i shoqërimit» ka mbetur jashtë lidhjeve predikative. Pamundësia e këmbimit të parafjalës *me* me lidhëzat bashkërenditëse shtuese *e*, *dhe*, *edhe*, si edhe rendi pak a shumë i lirë i «plotësit të shoqërimit» ndaj kryefjalës janë tregues i roleve të ndryshme gramatikore të kryefjalës dhe të «plotësit të shoqërimit», p.sh.: «A do të vish partizane *me Gjenën* ti, Hajrije?» — më pyeste mua. (Sh. Musaraj, Para agimit, II, f. 90).

Prandaj, duke qenë se «plotësi i shoqërimit» në këtë ndërtim është homogjen në brendi me kryefjalën, por gjuhësisht gjymtyrë e varur, si edhe «plotësi i vepruesit», është i padrejtë kategorizimi i tij si plotës, ai duhet kategorizuar si kundrinë.

«Plotësi i shoqërimit», në brendi, mund të jetë i njëvlershëm edhe me kundrinën e drejtë apo të zhdrejtë, por, me që mungon treguesi gramatikor i lidhjeve të veçanta, midis gjymtyrës nga ato varen dhe secilës nga këto gjymtyrë, togu: *kundrinë e drejtë* apo *e zhdrejtë* + «plotës shoqërimi» duhet marrë si kundrinë e vetme, p.sh.: U kujtua, kur pa komisar *Tojën me shokë* që shikuan njeri tjetrin të mahnitur. (Sh. Musaraj, Para agimit, II, f. 155).

Në të gjitha këto ndërtime, në sfera të caktuara të përdorimit, si në gjuhën e shtypit etj., mund të përdoren, në vend të parafjalës *me*, shprehjet parafjalore: *bashkë me*, *së bashku me*, p.sh.: Polikseni si robëtohej tërë ditën... dërgjej *së bashku me plakat* e tjera... mbi tryezat... kurse Mihali e kalonte natën me rehati në një dhomë *së bashku me Lllazar Mborjen*. (F. Gjata, Kënetat).

V — Nga sa u shtjellua në këtë kumtesë, dalin këto konkluzione:

1. Përkufizimi i kundrinës duhet zgjeruar si në planin e përmbajtjes, ashtu edhe në planin e shprehjes.

2. Duhet pranuar e trajtuar kundrinë me parafjalë.

3. Si lloje të veçanta të kundrinës me parafjalë duhen trajtuar edhe «plotësi i vepruesit», në disa ndërtime të caktuara edhe «plotësi i shoqërimit».

LISTA E VEPRAVE TË SHFRYTËZUARA

Nga autorët vendas:

1. *Cipo K.* — Sintaksa, Tiranë 1952.
— Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë 1949.
2. *Çeliku M.* — Çështje të normës morfologjike në letërsinë artistike pas çlirimit, në «Studime filologjike»; SF, 3, 1969.
3. *Demiraj Sh.* — Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe I, II (dispensë) Tiranë, 1967; «Rreth disa problemeve të paskajores në gjuhën shqipe» në «Studime filologjike» 1, 1969.
— «Rreth kategorisë së shquarësisë e të pashquarësisë në gjuhën shqipe», në «Studime filologjike» 1969, Nr. 4.
— Diskutimi për kumtesën e O. Buchholz në «Actes du premier congrès international des études balkaniques et sud-est européennes, VI, linguistique, Sofia 1968, f. 726.
4. *Domi M.* — Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksë për shkollat pedagogjike, Tiranë 1966.
— Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa për shkollat e mesme, botim i tretë, Tiranë 1957.
— Leksione të lexuara para studentëve të degës së gjuhës dhe letërsisë shqipe të Fakultetit të historisë dhe filologjisë.
— Morfologjia historike e shqipes. Dispensë. Tiranë 1961.
5. *Dhrimo A.* — «Një vështrim mbi foljet me më se një reksion në shqipen e sotme letrare» në «Studime filologjike», 2, 1965.
6. *Floqi S.* — «Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme» në «Studime filologjike», 1, 1968.
— «Mbi disa çështje të rendit të fjalëve në shqipen e sotme» në «Studime filologjike», 2, 1969.
— Leksione të lexuara në degën e gjuhëve të huaja të Fakultetit të historisë dhe filologjisë.
— Diskutimi për kumtesën e O. Buchholz në «Actes du premier congrès international des études balkaniques et sud-est européennes, VI, Linguistique, Sofia 1968, f. 727.
7. *Havjari N.* — Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa për klasën VII, Tiranë 1967.
8. *Prifti S.* — Sintaksa e gjuhës shqipe (dispensë) Pjesa I, Tiranë 1959.
9. *Rrota J.* Syntaksa e gjuhës shqipe, Shkodër 1944.
10. *Sheperi I.D.* — Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe, sidomos e toskënishtes. Vlonë 1927.
11. *Xhuvani A.* — Njohurit e para të sintaksës, 1935.
— Sintaksa shqipe, Tiranë 1938.
— Parafjalët në «Studime filologjike» 1, 1964.

Nga grammatikat e huaja:

1. ANSSSR. — Grammatika russkogo jazyka, Tom. II, Sintaksis, Moskva 1960.
2. ARPR — Grammatika limbii romine, Bucuresti, 1963.
3. Sovremennyj, ruskij jazyk, II, red. prof. E.M. Gallkinoj — Fjedoruk, izd. Moskovskogo Universiteta, 1964.
4. *Akullova K. P.* — O razgranichenii obstojatelstva i dopollnenije (na materjale nemeskogo jazyka) në «Voprosy germanskoj fillologjii, Vypusk II, 1969.
5. *Asan F.* — Reluarea complementului în limba romînă në «Studii de gramatică, vol. al III lea, București 1961
6. *Buchholz Ó.* — «Zur Frage der Verdoppelung der Objekte im Albanischen» në Actes du premier congrès international des études balkaniques et sud-est européennes; VI. Linguistique. Sofia 1968.
7. *Budagov R. A.* — Stjudy po sintaksisu rumynskogo jazyka AN SSSR, Moskva 1958.
8. *Cychun C.* — Sintaksis mestoimennyh klitik v juzhno sllavjanskih jazykah, Minsk 1968.
9. *Graur Al.* — Për rimarjen e kundrinës në Limba romana 1, 1969.
10. *Gougenheim G.* — Système gramatical de la langue française, Paris, 1966.
11. *Gvozdjev A.N.* — Sovramennyj russkij literatyrnyj jazyk II, Moskva 1961.
12. *Jespersen O.* — The Philosophy of Grammar (8th edition) London 1958.
13. *Kroteviç E. V.* Çleny predložhenija v. sovremennom russkom jazyke, Lvov, 1954.
14. *Rudnev A.G.* — Sintaksis sovremennogo russkogo jazyka, M. 1966.
— Sintaksis prostogo predložhenija. M. 1960.
15. *Smirnickij A.I.* — Sintaksia anglijskogo jazyka, Moskva 1957.
16. *Walter H.* — «Zum Problem der sog verdoppelte, objekte in den Balkansprachen» në «1 er congrès international des études balkaniques et sud-est européennes, Resumés des communications, Linguistique», Sofia 1966.
17. *Wackernagel J.* — Uber ein Gesetz der indogermanischen Wortstellung në Indogermanische Forschungen I, 1892.
18. *Vinogradov V.V.* — «Osnovnye voprosy sintaksisa predložhenija» (na materiale russkogo jazyka)
në «Voprosy gramatiçeskogo stroja. M. 1955.
19. *Zhigadllo V. N.* Tipy dollollnenija v drevneanglijskom jazyke në «Uçjonye zapyski L.G.U. Nr. 233. Germanskoe jazykoznanie.